



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 288/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë , duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugët te trafikut për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1150(njëmijë e njëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 21. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 20 tetor 2013 rreth orës 15:35 në rrugën Gjergj Kastriot Skënderbeu në Malishevë anëtarë të subjektit politik PDK kane vendosur mbi rrugët publike banerin me fotografi te kandidatit për kryetar nga rradhet e këtij subjekti politik Isni Kilaj. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografimin si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën përgjigje mes të tjerash theksohet se vendosja e banerit te kandidatit të PDK-së nuk është bere nga ana e strukturave te PDK-se. PDK konfirmon qe me të pranuar njoftimin për vendosjen e banerit te kandidatit te PDK mbi rruget publike të trafikut, aktivistët e PDK-së kanë shkuar ne vendin e caktuar dhe kane bërë largimin e këtij baner.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se baneri i kandidatit nga radhët e PDK-së, i vendosur mbi rrugët publike në komunën e Malishevës, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Andaj vendosja e banerit të kandidatit të saj mbi rrugët publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime konkrete duke e larguar menjëherë banerin e kandidatit të saj nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik PDK-së ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.

Andaj meqenëse baneri i kandidatit nga rradhët e PDK-së është i vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të këtij subjekti që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e tjera të ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 288/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*